



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nr. Prot. *Nr prot 596*

Tiranë, më 15 Nëntor 2022

Drejtuar: Z. Ulsi Manja
Ministër
Ministria e Drejtësisë

Nga: Znj. Erida Skëndaj
Drejtore Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Lënda: Sugjerime dhe mendime për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve””

I nderuar Z. Ministër,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në përmbushje të misionit dhe veprimtarisë së tij, pasi u njoh me përmbajtjen e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve” dhe relacionin të tij shoqërues, çmoi të nevojshme përcjelljen e disa mendimeve dhe sugjerimeve si vijon:

1. Me anë të nenit 1 të projektligjit, sugjerohen ndryshime në nenin 14, pika 1 të ligjit në fuqi nr.80/2020. Lidhur me shprehjen “përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”, është e paqartë nëse ka një vendim në fuqi të Këshillit të Ministrave që përcakton llojet e armatimit, lëndëve neuroparalizuese dhe mjeteve të tjera të përdorimit të forcës apo nëse ky vendim do të dalë në bazë dhe për zbatim të këtij neni.

Nga kërkimi në librarinë e akteve nënligjore, KShH vëren se Këshilli i Ministrave ka miratuar një vendim Nr. 549, datë 29.9.2021, “Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese, të mjeteve dhe pajisjeve të tjera kufizuese, për përdorimin e forcës nga garda e Republikës së Shqipërisë”. Në përmbajtje të kësaj VKM-je, në ndryshim nga emërtimi i përdorur në titull “për lëndët neuroparalizuese”, jepet përkufizimi i municioneve me lëndë kimike (irrituese/ngacmuese) në formë pluhuri ose lëngu për përdorim policor, që hidhen me shotgun/lëshues, me granatë dore, pajisje hedhëse, spray (individual/kolektiv) ose tubat, për mbrojtjen, menaxhimin e kontrollin e turmave, të cilat nuk sjellin dëme të pakthyeshme të shëndetit dhe janë në përputhje me legjislacionin në fuqi kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, me kufi ngacmues 0.05–0.1 mg/m³, kufiri toksik 1–5 mg/m³, indeksi i avullimit 40.000–75000 mg/min/m³.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Duke j 'u referuar këtij përkufizimi të lëndëve neuromparalizuese, të bërë në VKM nr.549, dt.29.09.2021, për KShH është e paqartë se çfarë do të konsiderohet lëndë neuromparalizuese në kuptim të ligjit nr.80/2020. Ligji gjithashtu duhet të parashikojë disa garanci minimale për përdorimin e këtyre lëndëve, të cilat në ndryshim nga rastet e aplikimit në menaxhimin dhe kontrollin e turmave sipas VKM-së në fuqi për Gardën e RSH, për sistemin e burgjeve duhet t'i nënshtrohen disa kriterëve të rrepta. Kështu, nëse në pikën 3 të nenit 14 ndalohet përdorimi i armëve brenda regjimit të brendshëm, lidhur me lëndët neuromparalizuese nuk ka një kufizim të tillë (nëse shtesa e propozuar miratohet nga Kuvendi). Përdorimi i këtyre lëndëve në mjedise të mbyllura të regjimit mund të ketë pasoja të dëmshme dhe me rrezik për jetën dhe shëndetin e personave të privuar nga liria dhe stafit të IEVP-së.

2. Në nenin 2 të projektligjit, me të cilin propozohen shtesa dhe ndryshime në nenin 29 të ligjit ekzistues ku personi mund të konkurrojë kur ndaj tij nuk është nisur një procedim penal dhe nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale me dashje. Ky formulim sipas nenit 2 të projektligjit është ndryshuar "a) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë." KShH vlerëson se ky formulim është i drejtë ashtu sic është i drejtë edhe formulimi për veprën e kryer me dashje apo nga pakujdesia me kushtin që të mos jetë rehabilituar. Ndërsa kur bëhet fjalë për rastin e veprave të kryera me dashje dhe nga pakujdesia kushtëzohet me faktin "që cenon figurën dhe integritetin e Policisë së Burgjeve". Për rëndësinë që ka figura dhe integriteti etikomoral i punonjësve që pranohen në policinë e burgjeve, KShH sugjeron që elementi i mos rehabilitimit duhet të jetë kriter pengues për aplikantët që janë dënuar penalisht por nuk janë rehabilituar (e pakushtëzuar nga lloji dhe natyra e veprës) dhe që duan të konkurrojnë në Policinë e Burgjeve. Rrjedhimisht, këtyre kandidatëve t'i mohohet e drejta e konkurrimit.

Në vijim të nenit 2 të projektligjit propozohet të shtohet një shtesë në nenin 29, për shkronjën "d" shtohet shkronja "d/1" si më poshtë "ndaj tij nuk është caktuar masa e sigurimit personal 'Arrest në burg' në 'arrest në shtëpi', për kryerjen e një vepre penale ose nuk ka marrë cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje". KShH sugjeron që ky formulim të rishikohet pasi në këtë formë interpretohet se nëse vepra penale është kryer nga pakujdesia, p.sh. vrasje nga pakujdesia apo vepra të tjera me pasoja të kryera nga pakujdesia, ai ka të drejtë të konkurrojë edhe sikur të jetë marrë i pandehur.

3. Lidhur me ndryshimet e propozuara me anë të nenit 3 të projektligjit, për ndryshime në nenin 42 të ligjit ekzistues, bazuar edhe në shpjegimet e dhëna në relacionin shoqërues, është e paqartë se përse ka lindur nevoja për të reduktuar kriterin e përvojës për tu rritur në gradën "Nënkomisar", e cila është grada më e lartë për një punonjës të rolit bazë dhe që sipas sistemit të karrierës të parashikuar në pikën 2, gërma "a", kërkohet një karrierë prej 14 vitesh në policinë e burgjeve që një punonjës i rolit bazë të gradohet si nënkomisar. KShH vlerëson se kriteret e propozuara me anë të pikës 2/1, krijojnë diferenca të konsiderueshme në raport me punonjësit që gradohen sipas shkallëve dhe kriterëve të

Address: Rr. Brigata e VIII,

Pll. Tekno-Projekt, Ap. 10, Tirana-Abania

P. O. Box /Kutia Postare No. 1752

Tel & Fax: ++355 (0)4 22 33671

e-mail: office@ahc.org.al

web address: www.ahc.org.al



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- përvojës në karrierë, në kuptim të pikës 2 gërma "a" të ligjit në fuqi, dhe përbën një diskriminim jo të përligjur objektivisht dhe në mënyrë të arsyeshme. Me kriteret e shtuara në nenin 2/1, për të fituar gradën "nënkomisar", mund të ndodhemi para rasteve abuzive të marrjes së kësaj grade për një punonjës bazë që nuk ka karrierën e nevojshme në policinë e burgjeve, bazuar në vlerësimet potencialisht të natyrës subjektive të trajnimeve profesionale dhe procedurave konkurruese.
4. Në nenin 4 të projektligjit, me të cilin propozohen ndryshime në nenin 51 të ligjit ekzistues për pikën 1, shkronja b), cilësohet si i pandehur për një krim të kryer me dashje pavarësisht se nuk është vendos masë arresti, hetimi mund të vazhdojë për një kohë të gjatë. Sipas KShH a duhet (a do të ishte e rekomandueshme) që të mjaftohet vetëm me masën e pezullimit pavarësisht se ai konsiderohet i pafajshëm. Kemi parasysh se edhe kur hetimi vazhdon për një kohë relativisht të gjatë në kushtet kur ai është marrë i pandehur a do të ishte e përshtatshme, e rekomandueshme gjatë gjithë kësaj kohe ai të përfitonte 50% të pagës për gradë. Edhe në këtë rast ai konsiderohet i pafajshëm (por në rastin konkret është fjala për punonjësit e policisë së burgjeve.
 5. Lidhur me ndryshimet e propozuara në nenin 5 të projektligjit, me anë të të cilit bëhen ndryshime të konsiderueshme në nenin 55 të ligjit në fuqi, KShH sugjeron që të saktësohet se ndaj kujt kanë përparësi për pranim, subjektet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni. Në vlerësimin e KShH-së, përparësia e tyre nuk duhet të jetë ndaj personave të punësuar më parë në policinë e burgjeve, të cilët kërkojnë të rikthehen nëse plotësojnë kushtet dhe kriteret e përmendura në këtë dispozitë. Diferenca në këtë drejtim mund të bëhen vetëm për shkak të gradës që kanë mbajtur më parë, pra nëse subjektet e përmendura në pikën 4, kanë mbajtur grada më të larta në raport me ato të policisë së burgjeve dhe kërkojnë të rikthehen me të njëjtën gradë apo të barazvlefshme me to. Lidhur me pikën 8 të projektligjit, KShH vlerëson se lind nevoja për të saktësuar realizimin e ekuivalentimit me akt nënligjor dhe jo rast pas rasti, pasi kjo do të krijonte premisa për zbatimin e standardeve të ndryshme në kuptim të zbatimit të këtij neni.

Shpresojmë që sugjerimet e mësipërme t'i shërbejnë përmirësimit të mëtejshëm të dispozitave të këtij projektligji.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm!

Me konsideratë,

Erida Skëndaj
Drejtoresh Ekzekutive

Address: Rr. Brigata e VIII,
Pll. Tekno-Projekt, Ap. 10, Tirana-Abania
P. O. Box /Kutia Postare No. 1752

Tel & Fax: ++355 (0)4 22 33671
e-mail: office@ahc.org.al
web address: www.ahc.org.al